

FJALA E DEPUTETES ILDA DHORI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

Përshëndetje!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Jemi duke diskutuar buxhetin e vitit 2022, menaxhimin e parave të taksapaguesve shqiptarë. Po flitet për një buxhet të rritur në raport me 1 vit më parë. Kjo është një traditë tashmë, pasi shifrat historikisht kanë qenë të rritura nga viti në vit, por jo gjithmonë janë përkthyer në ekonomi më të fortë për familjet shqiptare. A do ta rrisë ky buxhet mirëqenien e familjeve shqiptare? Unë jam shumë skeptike, sepse mbetet një buxhet i orientuar në pagesa të majme për koncesione dhe PPP. Jemi duke jetuar ende në kohë pandemie, por ka shumë pak buxhet për rimbursimin e barnave anti-COVID, ndërkohë që koncesionarët ruajnë dukshëm prioritetet e tyre. Pak më parë foli kolegja ime e Komisionit të Shëndetësisë, e cila renditi të gjitha ndërtesat e bëra në shëndetësi, spitalet, qendrat shëndetësore dhe të tjerat që do të bëhen në vitin 2022 e në vazhdim. E pranoj që kanë punuar për të ngritur ndërtesa. Çdo qeveri do t'i ketë pjesë të infrastrukturës së domosdoshme në shëndetësi, por duhet të theksojmë se në këto qendra në Shqipëri kemi mungesë, largim dhe boshatisje nga viti në vit të mjekëve, infermierëve, burimeve njerëzore dhe personelit të specializuar. Shqiptarët, veçanërisht ata që janë më larg Tiranës, më në periferi të saj, po vuajnë përherë e më tepër mungesën e një shërbimi cilësor nga mjekë dhe infermierë profesionistë të specializuar. Çfarë bëjmë ne? Çfarë do të bëjë kjo qeveri me buxhetin e parashikuar për vitin 2022? Parashikohet rritja me 6% e pagës për mjekët dhe infermierët.

Në fakt, është më shumë indeksim i inflacionit për vitin 2022. Kjo është qesharake, nuk ka asnjë strategji konkrete se si duhet t'i mbajmë profesionistët më të mirë në vend, por jo vetëm, për t'u shërbyer shqiptarëve. Ne kemi vetëm një justifikim: është diçka globale, ndodh kudo, siç ndodh edhe te ne. Ndodh kudo, por ne po i lëmë qytetarët shqiptarë pa shërbime jetike, pa ato që japin shëndet për shqiptarët. Fatkeqësisht, pensionistët duhet të presin edhe 1 vit. Për ta nuk ka asgjë në buxhetin e vitit 2022, përveç indeksimit të inflacionit dhe një pule deti për festën e Vitit të Ri, pasi nuk mund të blejnë gjel me 5000 lekë në kushtet e shtrenjtimit të çmimeve, një bonus që nuk ndryshon asnjëherë, por duhet të kenë edhe fat kur ta marrin.

Do të doja ta falënderoja kolegen time të maxhorancës, zonjën Bozdo, për deklaratën e saj realiste për gjendjen e pensionistëve shqiptarë! E mbështes plotësisht deklaratën, konstatimet dhe propozimet për të përmirësuar gjendjen aspak dinjitoze, në të cilën jetojnë sot pensionistët në Republikën e Shqipërisë, të cilët duhet të kishin dinjitet në kohën e pensionit të tyre. Ky është buxheti që rrit vlerat e tij në total; buxheti që konsideron prioritet bujqësinë dhe ul me 2% shpenzimet për këtë sektor, krahasuar me 1 vit më parë; buxheti që kërkon të mbledhë edhe qindarkën e fundit nga xhepat e fermerëve shqiptarë, duke mos u garantuar asgjë. Paketa e re fiskale u jep përparësi vetëm investitorëve të mëdhenj. Tashmë jo investitorët me investime mbi 50 milionë lekë, por ata që duan 10-fish investime, së paku mbi 500 milionë lekë, do të përjashtohen nga TVSH-ja për makineritë dhe

pajisjet e importuara. Ky shtet nuk i përkrahu kurrë fermerët në tregun e shitjes së produkteve bujqësore brenda apo jashtë vendit dhe tani kërkon të mbërthejë grumbulluesit dhe eksportuesit, duke u hequr rimbursimin e TVSH-së dhe duke e bërë 0%, ndërkohë që ka qenë 20% në fillim dhe aktualisht është 6%. Duhet të pranojmë se grumbulluesit dhe eksportuesit janë një pikë kyçe në sigurimin e tregut për shitjen e prodhimeve bujqësore. Sot ata po protestojnë bashkë me fermerët në rrugë, sepse kjo gjë i bën të pasigurt për të nesërmen, ndihen të goditur nga qeveria dhe shteti. Mua më shqetëson impakti që do të kenë të gjitha këto nisma në paketën fiskale të fermerët e vegjël dhe të mesëm, që janë hallka më e pambrojtur e të gjithë zinxhirit; punojnë, prodhojnë dhe kurrë nuk kanë gjetur mbështetje nga kjo qeveri, sepse janë lënë në harresë.

Do të doja të ishte zonja ministre këtu dhe ta dëgjonte sërish: fermeri shqiptar është i lënë në harresë nga ju, zonja Ministre, që nuk jeni prezente, nga qeveria juaj, nga politikat tuaja propagandiste, të cilat nuk kanë arritur kurrë të depërtojnë te fermeri shqiptar; nuk kanë arritur kurrë të ulin koston e prodhimit të mallrave të tyre; kurrë nuk kanë arritur të japin subvencione për fermerin shqiptar. Kjo nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe ju veçse i keni lënë ata në harresë totale. Kur u referohem fermerëve, kam gjithmonë parasysh shumicën e tyre, të vegjël e të mesëm, jo pakicat me pikatore, që mund të kenë përfituar nga financimet e AZHBR-së me testerin e Pastrisë Socialiste. Heqja e TVSH-së së rimbursuar nga 6% në 0%, do të ekspozojë tregun e brendshëm në rritjen e koston së prodhimeve bujqësore, ndërkohë që do ta zhveshë komplet fermerin, duke ekspozuar uljen e çmimeve me të cilat ai do të detyrohet të shesë prodhimin e tij. Do të tkurren eksportet dhe do të nxiten importet, që është edhe politika e kësaj qeverie. Një koleg nga mazhoranca tha se këto para do t'u merren eksportuesve dhe do t'i jepen fermerit në formën e subvencioneve, nuk duhet të shqetësohen fermerët. Ju lutem, të nderuar kolegë, ju ose qeveria juaj, të flisni të gjithë nëse keni plane konkrete se si do të subvencionohet fermeri shqiptar. Ju lutem, na e thoni, që ne ta sqarojmë këtë mjegullnajë dhe fermerët të sqarojnë konfuzionin e krijuar nga ju me politikat tuaja, që parashikohen në paketën fiskale. Zgjidhja do të ishte vetëm subvencioni direkt te fermeri dhe dhënia fund e abuzimeve pa burokraci dhe pa domosdoshmërinë e tesarave partiakë për të përfituar. Unifikimi i akcizës së gazit me 6%, përfshirë gazin për gatim dhe ngrohje, do të rrisë dukshëm koston e tij në treg, dhe fatura finale do t'u shkojë familjeve shqiptare. Për sa i përket bujqësisë, sepse mua më intereson si sektor, pasi zona që përfaqësoj është kryesisht e tillë, do të rëndohen serrat prodhuese të fidanëve, të cilët përdorin gazin e lëngshëm si burim kryesor për ngrohje dhe kurrë nuk kanë marrë asnjë subvencion nga ky shtet. Dukshëm, fatura finale do të pasqyrohet te fermeri, i cili duhet të blejë fidanët. Mbi 95% e tyre i blejnë fidanët me kosto më të shtrenjtuar, por askush nuk mendon për këtë. Në fund, si qershia mbi tortë, keni vendosur të rivendosni TVSH-në, që ju vetë e hoqët, për inputet bujqësore, për plehrat kimike, për pesticidet, farërat dhe fidanët. Dikush nga kolegët tuaj tha se janë vetëm 9 milionë dollarë në buxhetin e shtetit. Çfarë do të ndodhë? E dini çfarë do të thotë 9 milionë dollarë më shumë për fermerët e Divjakës, të Lushnjës, të Myzeqesë, të Beratit dhe të gjithë Shqipërisë? Do të jenë shtesa mbi çmimet e kripura të plehrave, të farave dhe fidanëve, që aktualisht ata janë të detyruar të paguajnë. Ndërkohë, vetë ju jeni përgjegjës kryesor për monopolin e tregtisë së plehrave kimike dhe të pesticideve, që operojnë në kushtet e një tregu pa kurrfarë kontrolli të cilësisë dhe të çmimeve. Ndër të tjera, shikoj në zërat e buxhetit ulje të ndjeshme të investimeve për kanale kulluese dhe vaditëse.

Duhet të citoj se edhe kur kanë qenë të larta, asgjë nuk ka qenë e dukshme dhe e prekshme. Nuk ka pasur askund kanale kulluese dhe vaditëse për fermerin shqiptar, por tashmë mungesa e tyre do të jetë e legjitimuar dhe propaganda po stepet dukshëm në këtë drejtim. Fermerët jo rrallë kanë shkatërruar prodhimin për shkak të përmytjeve, që vijnë si pasojë e mungesës së kanaleve kulluese. Vaditja është bërë gjithmonë me pompa vaditëse; nuk ka pasur sisteme të vaditjes, edhe pse janë harxhuar miliona euro të shqiptarëve për këto qëllime, sepse lekët janë futur në xhepat e

pushtetarëve lokalë ose qendror apo klientëve të tyre. Rrugët rurale nuk janë ende një prioritet i kësaj qeveria. Duhet të presim për to.

Dua të shpreh votën dhe qëndrimin tim kundër këtij buxheti të orientuar drejt koncesioneve, PPP-ve, drejt klientelizmit dhe investitorëve të mëdhenj, duke çuar aty shumicën e parave të vjela nga taksapaguesit shqiptarë dhe duke i lënë këta të fundit në harresë totale. Do të votoj kundër paketës fiskale, e cila do të shkatërrojë fermerin, grumbulluesin, tregun e fruta-perimeve në vend, duke i lënë fermerët dhe bujqërit në harresë, të vetëm në përballjen e çdo lloji krize që kanë kaluar deri tani.